



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_097_2008
Nr.i Referencës ERO/CPD_D_84_05_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe proceset e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE: ZRRE?DMK_V_84_05_08 të datës 07 maj 2008;
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK-s nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 26 maj 2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit z. Ragip Zariqi (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 203119) kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori me datë 27 dhjetor 2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A – Divizion të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK Sh.A me datë 27 dhjetor 2006
2. Prapë konsumatori me datë 03 gusht 2007 ka bërë ankesë në KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë ku ka kërkuar lirim nga borxhi i energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK Sh.A me datë 03 gusht 2007.
3. KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë me datë 03 gusht 2007 e me numër reference DPR – CO1 – 08 iu ka përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se: KEK-u nuk ka bazë ligjore për faljen e borxheve për kategorinë e pensionistëve si dhe se faturimi për konsumatorin pa njehsor bëhet sipas rregullave në fuqi.
Provë: Përgjigja e KEK Sh.A e datës 03 gusht 2007 me numër të referencës DPR – CO1 – 08.
4. Me datë 03 gusht 2007 konsumatori ka apeluar në DMK të ZRRE-së përgjigjen e KEK-ut me numër të referencës DPR – CO1 – 08.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE e datës 03 gusht 2007, nr. 104/08 2007
5. Me datë 07 maj 2008 DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK Sh.A dhe konsumatorit ka vendosur që të refuzojë ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i DMK në ZRRE i datës 07 maj 2008.



6. Me datë 26 maj 2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK të ZRRE-së në Bordin e ZRRE-së.

Andaj për arsyet e paraqitura më lart, Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta refuzojë konsumatorin si në arsyetimin e paraqitur në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar